

Përmbledhje

Sistemi financiar në vend vazhdoi të zgjerohet edhe gjatë TM4 2018, megjithëse me ritëm më të ngadalësuar krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Rritja e aseteve të sistemit gjatë këtij tremujori i'u atribua kryesisht rritjes së aseteve të sektorit bankar dhe atij mikrofinanciar.

Gjatë tremujorit të katërt të vitit 2018, sektori bankar u karakterizua me rritje të aktivitetit kreditues, performancë të kënaqshme financiare si dhe nivel të favorshëm të indikatorëve kyç që matin shëndetin e sektorit. Asetet e sektorit bankar u rritën për 150.6 milionë euro në TM4 2018, kryesisht rezultat i rritjes së aktivitetit kreditues dhe parasë së mbajtur në trezor dhe në BQK. Rritja e aktivitetit kreditues përgjatë gjithë vitit 2018, si në bazë vjetore ashtu edhe në baza tremujore, i'u atribuua ofertës së lehtësuar dhe kushteve të favorshme të kreditimit, njëkohësisht edhe kërkesës së rritur për kredi.

Aktiviteti kreditor u mbështetet kryesisht nga depozitat e mbledhura brenda ekonomisë së vendit, të cilat në fund të TM4 2018 përfaqësuan 80.4 përqind të gjithsej detyrimeve dhe burimeve vetanake të sektorit. Në tremujorin e katërt, depozitat u rritën për 154.6 milionë euro, kryesisht rezultat i zgjerimit të depozitave të ndërmarrjeve të mbajtura në sektorin bankar në këtë periudhë.

Në kuadër ofertës kreditore, kosto e financimit nga bankat u karakterizua me përmirësim të mëtejme gjatë vitit 2018. Në tremujorit të katërt 2018, norma mesatare e interesit në kredi zbriti në nivelin më të ulët historik prej 6.3 përqind. Në të njëjtë periudhë, normat e interesit në depozita shënuan një rritje të lehtë vjetore dhe arritën në një mesatare prej 1.4 përqind.

Performanca financiare e sektorit bankar gjatë këtij tremujori u karakterizua me vlerë rekorde të profitit. Më konkretisht, në profitin e realizuar kontribuoi rritja e arkëtimit prej 17.4 përqind, kryesisht nga të hyrat nga interesi i kredive të lëshuara si dhe të hyrat nga tarifat dhe komisionet e shërbimeve të sektorit bankar. Përderisa, rritja vjetore e shpenzimeve, që reflekton kryesisht rritjen e shpenzimeve të përgjithshme dhe të

personelit, rezultoi të jetë më e ulët prej 6.2 përqind.

Cilësia e portofolit kreditor të sektorit bankar u përmirësua edhe mëtej, duke regjistruar nivelin më të ulët të kredive joperformuese që nga gjysma e dytë e vitit 2010, në 2.7 përqind

dhe duke siguruar mbulueshmëri të kënaqshme të kredive joperformuese me provizione (152.0 përqind). Për më tepër, Treguesi i Mjaftueshmërisë së Kapitalit (17.0 përqind) dhe nivel i likuiditetit (39.1 përqind) sugjerojnë që sektori bankar është i qëndrueshëm ndaj rreziqeve potenciale që mund të shfaqen.

Në tremujorin e katërt, me gjithë rritjen e kontributeve të reja, sektori pensional u karakterizua me performancë negative nga investimet. Si pasojë e luhatjeve të mëdha në tregjet financiare globale në dhjetor 2018, vlerësimi i aseteve të investuara jashtë vendit u zvogëluar dhe rezultoi në kthim negativ bruto nga investimet. Këto dinamika u reflektuan edhe në rënien e çmimit të njësisë.

Sektori i sigurimeve mbylli këtë tremujor me rezultat pozitiv financiar, mirëpo më të ulët krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit paraprak. Më saktësisht, faktorët që ndikuan në dinamikat e sektorit të sigurimeve ishin rritja në të hyrat neto nga primet, përderisa faktorët të cilët kontribuan negativisht ishte rritja e theksuar e dëmeve të ndodhura dhe rritja e shpenzimeve të sektorit krahasuar me TM4 2017.

Sektori mikrofinanciar ka vazhduar të rrisë aktivitetin, ku edhe në tremujorin e katërt u karakterizua me rritje të theksuar të aseteve si rezultat i rritjes së stokut të kredive. Njëkohësisht, dinamikat në këtë sektor dhe rritja e të hyrave mundësuan rritje të profitit gjatë këtij tremujori.

Tregu i letrave me vlerë të Qeverisë së Kosovës gjatë këtij tremujori u karakterizua me rritje të vlerës së emetuar dhe rritje të afatit të maturimit, si dhe kërkesë të lartë për të investuar në letrat me vlerë. Rritja e normës së përgjithshme të interesit në TM4 2018 mund t'i atribuohet deri në një masë orientimit drejt emetimit të letrave me vlerë me maturitet më të gjatë.

BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJE-----i

Sistemi Financiar-----	05
Sektori Bankar -----	05
Sektori Pensionsal -----	13
Sektori i Sigurimeve -----	15
Sektori Mikrofinanciar -----	17
Tregu i Letrave me Vlerë-----	20

GRAFIKËT DHE TABELAT

Figura 1. Vlera e asetëve të sistemit financiar të Kosovës -----	05
Figura 2. Asetet e sektorëve përbërës të sistemit financiar -----	05
Figura 3. Ndryshimi vjetor në strukturën e asetëve të sektorit bankar-----	06
Figura 4. Ndryshimi vjetor në vlerën e gjithsej kredive dhe kategorive kryesore -----	06
Figura 5. Struktura e kredive sipas veprimtarisë ekonomike-----	07
Figura 6. Struktura e detyrimeve dhe burimeve vetanake -----	08
Figura 7. Vlera e gjithsej depozitave dhe kategorive kryesore në TM4 -----	08
Figura 8. Struktura e bilancit të depozitave në TM4-----	08
Figura 9. Norma e interesit në kredi dhe depozita -----	09
Figura 10. Norma e interesit në kreditë ndaj ndërmarrjeve dhe ekonomive familjare -----	09
Figura 11. Norma e interesit në kredi, sipas sektorëve ekonomik -----	10
Figura 12. Norma e interesit në kreditë ndaj ekonomive familjare-----	10
Figura 13. Norma e interesit në depozitat -----	10
Figura 14. Norma e interesit në depozitat e ndërmarrjeve -----	10
Figura 15. Norma e interesit në depozitat e ekonomive familjare -----	11
Figura 16. Profiti neto i sektorit bankar -----	11
Figura 17. Të hyrat dhe shpenzimet e sektorit bankar -----	11
Figura 18. Treguesit e profitabilitetit të sektorit bankar -----	12
Figura 19. Treguesit e kualitetit të portofolios kreditore dhe norma e rritjes së KJP-ve-----	12
Figura 20. Treguesit e likuiditetit dhe të solvencës -----	13
Figura 21. Asetet e sektorit pensionsal -----	13
Figura 22. Struktura e asetëve të FKPK-së -----	14
Figura 23. Struktura e asetëve të FSKP-së -----	14

Figura 24. Kthimi në investime dhe performanca e FKPK-së-----	14
Figura 25. Asetet e sektorit të sigurimeve -----	15
Figura 26. Primet e shkruara dhe dëmet e paguara -----	16
Figura 27. Asetet e sektorit mikrofinanciar -----	17
Figura 28. Vlera e kredive ndaj ekonomive familjare dhe ndërmarrjeve -----	17
Figura 29. Vlera e kredive ndaj ndërmarrjeve, sipas sektorëve ekonomik -----	18
Figura 30. Vlera e lizingjeve të sektorit mikrofinanciar -----	18
Figura 31. Norma mesatare e interesit në kredi të sektorit mikrofinanciar -----	18
Figura 32. Norma mesatare e interesit në kredi për ndërmarrje, sipas sektorëve ekonomik -----	19
Figura 33. Të hyrat dhe shpenzimet e sektorit mikrofinanciar -----	19
Figura 34. Treguesit e profitabilitetit të sektorit mikrofinanciar -----	19
Figura 35. Treguesit e kualitetit të portofolios kreditore -----	20
Figura 36. Shuma e borxhit të emetuar -----	20
Figura 37. Shuma e ofruar dhe e emetuar-----	21
Figura 38. Struktura e letrave me vlerë të Qeverisë -----	21
Tabela 1. Numri dhe shuma e letrave me vlerë të arkëtuara nga Qeveria e Kosovës -----	20
Tabela 2. Treguesit e zgjedhur makroekonomik -----	23


SHKURTESAT:

APR	Asetet e Peshuara ndaj Rrezikut
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
BPV	Bruto Produkti Vendor
BQK	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
CHF	Franku Zvicërran
EJL	Evropa Juglindore
EUR	Valuta Euro
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
GBP	Poundi Britanik
IHD	Investimet Huaja Direkte
KJP	Kreditë Jopërfomuese
KMA	Kthimi Mesatar në Asete
KMK	Kthimi Mesatar në Kapital
MF	Ministria e Financave e Republikës së Kosovës
NRER	Norma Reale Efektive e Këmbimit
TMK	Treguesit e Mjaftueshmërisë së Kapitalit
USD	Dollari Amerikan
WEO	World Economic Outlook

Sistemi Financiar

Vlera e gjithsej asetëve të sistemit financiar të Kosovës arriti në 6.32 miliardë euro në fund të TM4 2018, që përkon me një rritje vjetore prej 7.0 përqind (figura 1). Sektori bankar vazhdon të ketë kontributin kryesor në zgjerimin e aktivitetit të sistemit financiar në vend, pasuar nga sektori mikrofinanciar. Për dallim nga vitet e fundit kur sektori pensional kishte kontribut ekuivalent me atë të sektorit bankar në zgjerimin e asetëve të sistemit, kthimi negativ nga investimet në vitin 2018 ndikoi në zvogëlimin e kontributit të këtij sektori në rritjen e gjithsej asetëve të sistemit.

Figura 1. Vlera e asetëve të sistemit financiar të Kosovës




Shënim: Të dhënat e paraqitura janë me gjendjen në fund të tremujorit të cekur
Burimi: BQK (2019)

Në baza tremujore, asetet e sistemit financiar u rritën për 96.6 milionë euro në TM4 2018, kryesisht si rezultat i rritjes së shënuar të asetëve të sektorit bankar (për 150.6 milionë euro) dhe sektorit mikrofinanciar (për 13.7 milionë euro). Në anën tjetër, segmentet tjera të sistemit financiar si sektori pensional dhe ai i sigurimeve u zvogëluan në TM4 2018, për 64.7 milionë euro, përkatësisht 3.8 milionë euro (figura 2).

Zgjerimi i aktivitetit të sektorit bankar dhe atij mikrofinanciar vijon të mbështetet kryesisht nga depozitat e mbledhura, përkatësisht huazimet nga sektori i jashtëm (linjave të ndryshme kreditore). Ndërsa, tkurrja e asetëve të sektorit pensional i'u atribuua kryesisht kthimit negativ nga investimet gjatë TM4 2018.

Figura 2. Asetet e sektorëve përbërës të sistemit financiar



Sektori Bankar


Sektori bankar gjatë këtij tremujori vazhdoi të karakterizohet me rritje të lartë të aktivitetit kreditues, pasasë së gatshme në trezor dhe BQK, kurse rënie të lehtë të investimeve në letrat me vlerë.

Asetet

Në TM4 2018, asetet e sektorit bankar u rritën për 150.6 milionë euro dhe arritën vlerën prej 4.18 miliardë euro në fund të periudhës. Rritja e përgjithshme e asetëve të sektorit bankar i atribuohet dinamikave pozitive të kreditimit, aktivitet që u mbështet si nga oferta e lehtësuar e bankave përmes ofrimit të kushteve më të mira për kredidhënie, ashtu edhe nga

kërkesa e rritur për kredi. Kurse, në baza tremujore, përjashtuar investimet në letrat me vlerë, të gjitha kategoritë e aseteve shënuan rritje gjatë TM4 2018 (figura 3).

Figura 3. Ndryshimi vjetor në strukturën e aseteve të sektorit bankar



Burimi: BQK (2019)

Për dallim nga tremujori i njëjtë i vitit paraprak, paraja e gatshme dhe bilanci me BQK-në shënoi rritje të theksuar në TM4 2018, duke u zgjeruar për 58.0 milionë euro (për 2.4 milionë në TM4 2017) dhe arritur vlerën prej 541.8 milionë euro në fund të periudhës. Përshpejtimi i rritjes së kësaj kategorie kryesisht reflekton nivelin e parasë së gatshme të mbajtur në trezor të bankave, dhe në masë më të vogël në BQK. Bilanci me bankat tjera u karakterizua me rritje prej 10.7 milionë euro në TM4 2018, nga rënia prej 40.5 milionë euro në TM4 2017, dhe arriti vlerën prej 340.8 milionë euro në fund të periudhës së cekur.


Në TM4 2018, stoku i letrave me vlerë të sektorit bankar u zvogëluar për 4.0 milionë euro dhe zbriti në vlerë prej 430.2 milionë euro në fund të periudhës raportuese. Investimi në letrat me vlerë të qeverisë së Kosovës vazhdon të shënojë rritje, mirëpo investimet në letrat me vlerë të qeverive të huaja shënuan rënie,

dinamikë që u reflektua në rënien e përgjithshme të investimeve në këtë instrument gjatë TM4 2018.

Kreditë

Aktiviteti kreditues vazhdon të karakterizohet me rritje të theksuar edhe gjatë TM4 2018. Në fund të periudhës së cekur, kreditë arritën vlerën prej 2.76 miliardë euro, që përkon me një rritje vjetore prej 10.9 përqind. Në baza tremujore, kreditë u rritën për 74.4 milionë euro, krahasuar me rritjen për 78.4 milionë euro në TM4 2017 (figura 4).

Figura 4. Ndryshimi vjetor në vlerën e gjithsej kredive dhe kategorive kryesore




Burimi: BQK (2019)

Ndikim pozitiv në rritjen e kredive aktive gjatë TM4 2018 kishin kreditë e reja të lëshuara si për ndërmarrjet (të cilat shënuan vlerën prej 231.0 milionë euro) ashtu edhe për ekonomitë familjare (që shënuan vlerën prej 133.6 milionë euro). Ofertat më të favorshme bankare, shprehur përmes përmirësimit të kushteve të kreditimit si për ndërmarrjet edhe ekonomitë familjare rezultuan në rritjen e gjithë stokut të kredive aktive deri në fund të periudhës së cekur. Gjithashtu, rritja e kërkesës për kredi nga të dy kategoritë, rezultoi në rritje të përgjithshme të aktivitetit kreditues përgjatë gjithë tremujorëve të vitit 2018.

Në TM4 2018, kreditë për ndërmarrje shënuan rritje për 49.0 milionë euro (rritje për 55.3 milionë euro në TM4 2017), duke arritur vlerën prej 1.75 miliardë euro në fund të periudhës së cekur. Në baza vjetore, në fund të TM4 2018, përjashtuar kreditimin ndaj sektorit të bujqësisë dhe atë të minierave që u karakterizuan me rënie, kreditimi ndaj të gjithë sektorëve tjerë ekonomik u karakterizua me rritje.

Figura 5. Struktura e kredive sipas veprimtarisë ekonomike



Kurse, në baza tremujore, efekti i sezonalitetit dhe dinamikat me të cilët karakterizohen sektor të ndryshëm ekonomik rezultojnë në luhatje të mëdha nga viti në vit. Në këtë kontekst, sektori i shërbimeve tjera u rrit për 34.5 milionë euro në TM4 2018 (rritje për 1.4 milionë euro në TM4 2017), ndërsa sektori i tregtisë u rrit për 0.2 milionë euro krahasuar me rritjen për 32.0 milionë euro në TM4 2017. Zhvillimet në sektorët tjerë nuk rezultuan të kenë ndryshime të theksuara kundrejt TM4 2017 (figura 5). Kreditë e reja për ndërmarrje arritën vlerën në 231.0 milionë euro gjatë TM4 2018, prej të cilave 152.8 milionë euro të rezultuan si kredi të destinuar për investime, kurse 69.8 milionë euro për qëllime jo-investuese. Kreditë e reja për sektorin e bujqësisë në TM4 2018 arritën vlerën prej 6.5 milionë euro, një rritje prej 0.3 milionë

euro kundrejt TM4 2017. Kreditë e reja të destinuar për industrinë u rritën për 41.2 milionë euro dhe arritën vlerën në 80.7 milionë euro në TM4 2018. Kurse, kreditë e reja për sektorin e shërbimeve u zvogëluan për 31.4 milionë euro, duke rënë në vlerën prej 107.7 milionë euro në TM4 2018.


Kreditë ndaj ekonomive familjare në TM4 2018 u rritën për 25.3 milionë euro, duke arritur vlerën e stokut të gjithsej kredive prej 998.5 milionë euro në fund të periudhës së cekur. Sa i përket kredive të reja për ekonomitë familjare, në këtë tremujor është evidentuar rënie për 10.3 milionë euro, gjë që rezultoi në vlerën e përgjithshme të shënuar në TM4 2018 prej 133.6 milionë euro. Kjo rënie u reflektua më shumë tek kreditë e reja konsumuese, të cilat gjatë TM4 2018 u zvogëluan për 10.5 milionë krahasuar me TM4 2017, në 95.5 milionë euro. Kurse, ato hipotekare, gjatë TM4 2018 arritën vlerën në 24.4 milionë euro, një nivel i ngjashëm me TM4 2017.

Detyrimet dhe burimet Vetanake

Struktura e detyrimeve të sektorit bankar dominohet nga depozitat, të cilat përbëjnë 80.4 përqind të gjithsej detyrimeve dhe burimeve vetanake. Në këtë tremujor, rritja e nivelit të depozitave për 154.6 milionë euro rezultoi të jetë dukshëm më e lartë krahasuar me rritjen prej 47.7 milionë euro në TM4 2017 (figura 6).

Kategoria e burimeve vetanake u karakterizua me rritje për 26.1 milionë euro në TM4 2018 (14.2 milionë euro rritje gjatë TM4 2017). Kjo rritje i atribuohet kryesisht fitimit të realizuar gjatë tremujorit raportues. Në fund të TM4 2018, vlera e kapitalit të bankave arriti në 496.7 milionë euro.

Figura 6. Struktura e detyrimeve dhe burimeve vetanake




Burimi: BQK (2019)

Kurse, kategoria e cila shënoi rënie të theksuar gjatë këtij tremujori ishte ajo e bilancit nga bankat tjera, që u zvogëlua për 23.1 milionë euro, rënie që kryesisht reflekton zvogëlimin e huazimeve apo linjave të ndryshme kreditore nga bankat jashtë vendit, përkatësisht bankat amë. Në fund të TM4 2018, vlera e huazimeve prej bankave komerciale arriti vlerën për 106.6 milionë euro.

Depozitat

Figura 7. Vlera e gjithsej depozitave dhe kategorive kryesore në TM4




Burimi: BQK (2019)

Depozitat në sektorin bankar të Kosovës u rritën për 154.6 milionë euro në TM4 2018 në baza tremujore, dhe shënuan vlerën prej 3.36 miliardë euro. Zhvillimet në

kuadër të depozitave të sektorit bankar në TM4 2018 i atribuohen kryesisht ecurisë së depozitave për ndërmarrjet, pa anashkaluar dhe kontributin e rëndësishëm të ekonomive familjare. Depozitat e ndërmarrjeve u rritën për 104.7 milionë euro në këtë tremujor dhe arritën vlerën prej 872.4 milionë euro në fund të periudhës së cekur.

Figura 8. Struktura e bilancit të depozitave në TM4



Burimi: BQK (2019)


Në anën tjetër, depozitat për ekonomitë familjare u rritën për 58.2 milionë euro në këtë tremujor, dhe arritën vlerën prej 2.33 miliardë euro në fund të periudhës së cekur (figura 7).

Sipas kategorive të depozitave, depozitat e transferueshme u rritën për 84.5 milionë euro në TM4 2018 (figura 8), dhe shënuan vlerën prej 2.01 miliardë euro në fund të periudhës së cekur. Po ashtu, depozitat e afatizuara u rritën për 63.6 milionë euro në këtë tremujor dhe arritën vlerën prej 881.5 milionë euro në fund të periudhës. Përderisa, depozitat e kursimit u rritën për 6.5 milionë euro në baza tremujore, dhe arritën vlerën prej 469.1 milionë euro në fund të periudhës së cekur.

Normat e Interesit¹

Në TM4 2018, norma e interesit në kredi ka shënuar rënie vjetore, duke arritur nivelin më të ulët historik, kurse në depozita ka shënuar rritje kundrejt periudhës së njëjtë të vitit të kaluar. Dallimi në mes të normës të interesit në kredi dhe asaj në depozita u zvogëluar në 4.9 pikë përqindje në periudhën raportuese (5.7 pikë përqindje në TM4 2017).

Figura 9. Norma e interesit në kredi dhe depozita



Burimi: BQK (2019)

Norma e interesit në kredi në TM4 2018 u zvogëluar për 0.5 pikë përqindje, në 6.3 përqind, përderisa norma e interesit në depozita shënoi rritje për 0.3 pikë përqindje, në 1.4 përqind (figura 9).


Normat e interesit në kredi

Norma e interesit në kreditë ndaj ndërmarrjeve u zvogëluar në 6.1 përqind, nga 6.4 përqind sa ishte në TM4 2017 (figura 10).

Pothuajse të gjitha kategoritë e normave të interesit në kreditë ndaj ndërmarrjeve shënuan rënie vjetore në TM4 2018. Rënia më e madhe (0.5 pikë përqindje) u

shënuar tek kreditë për qëllime investuese, kredi që kishin një normë interesi prej 6.0 përqind. Kategoria e mbitërheqjeve shënoi rënie për 0.1 pikë përqindje krahasuar me TM4 2017, në 6.5 përqind. Kurse, normat e interesit të aplikuara për kreditë me kushte favorizuese mbetën të ngjashme me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, me normë prej 2.5 përqind. Në të njëjtën periudhë, normat e interesit të aplikuara në kreditë për qëllime jo-investuese bartën normë të interesit prej 6.3 përqind, që paraqet një rritje vjetore prej 0.2 pikë përqindje.

Figura 10. Norma e interesit në kreditë ndaj ndërmarrjeve dhe ekonomive familjare




Burimi: BQK (2019)

Normat e interesit në kreditë ndaj sektorëve ekonomik u zvogëluar për pothuajse të gjitha veprimtaritë ekonomike, përjashtuar sektorin e bujqësisë ku shënuar rritje vjetore prej 1.0 pikë përqindje në 7.7 përqind (figura 11). Normat e interesit në kreditë për sektorin e industrisë u zvogëluar për 0.5 pikë përqindje, në 5.9 përqind në TM4 2018. Në sektorin e shërbimeve, norma e interesit në kredi u zvogëluar për 0.1 pikë përqindje, në 6.3 përqind në TM4 2018. Kurse, rënie më e theksuar e normës së interesit në kredi, për

¹ Kalkulimi i normave të interesit: mesatarja tremujore e normave të interesit në kredi, gjegjësisht në depozita. Në tekst ju referohemi si 'normë e interesit'.

1.0 pikë përqindje u shënua ndaj sektorëve tjerë, në 5.5 përqind në TM4 2018.


Figura 11. Norma e interesit në kredi, sipas sektorëve ekonomik



Burimi: BQK (2019)

Edhe normat e interesit në kreditë ndaj ekonomive familjare ndoqën trendin e përgjithshëm të normave të interesit të aplikuara nga bankat. Normat e interesit të aplikuara për kreditë hipotekare vazhdojnë të jenë më të favorshme, kurse rënie më e theksuar u evidentua në kreditë konsumuese.

Figura 12. Norma e interesit në kreditë ndaj ekonomive familjare, sipas qëllimit



Burimi: BQK (2019)


Në TM4 2018, norma e interesit e aplikuar për kreditë hipotekare qëndroi në 5.9 përqind, një nivel i ngjashëm me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Në të njëjtën periudhë, norma e interesit e aplikuar për kreditë konsumuese ishte 7.2 përqind, që paraqet një rënie prej 10

0.7 pikë përqindje krahasuar me periudhën paraprake (figura 12).

Normat e interesit në depozita

Normat e interesit në depozita vijuan trendin rritës gjatë katër tremujorëve të vitit 2018 krahasuar me vitin 2017. Edhe pse në nivele të ulëta krahasuar me periudhat para vitit 2014, norma mesatare e interesit në depozita gjatë TM4 2018 rezultoi të jetë për 0.3 pikë përqindje më e lartë se në TM4 2017, në 1.4 përqind (figura 13).


Figura 13. Norma e interesit në depozita



Burimi: BQK (2019)

Normat e interesit në depozitat për ndërmarrjet vazhdojnë të jenë më të larta krahasuar me normat që ofrohen për ekonomitë familjare.


Figura 14. Norma e interesit në depozitat e ndërmarrjeve, sipas kategorive



Burimi: BQK (2019)

Në depozitat e ndërmarrjeve, norma e interesit qëndroi në nivel prej 1.6 përqind në TM4 2018, ngjashëm me periudhën paraprake. Norma e interesit në depozitat e afatizuara ishte 1.6 përqind, ngjashëm me TM4 2017. Po ashtu, edhe normat e interesit në depozitat e kursimit dhe ato të transferueshme mbeten në nivele të ngjashme me periudhën paraprake, në 0.4 përqind përkatësisht 0.01 përqind (figura 14).

Figura 15. Norma e interesit në depozitat e ekonomive familjare, sipas kategorive



Burimi: BQK (2019)


Normat e interesit në depozitat e ekonomive familjare shënuan rritje vjetore për 0.4 pikë përqindje në TM4 2018 dhe qëndruan në 1.3 përqind (figura 15). Norma e interesit në depozitat e transferueshme ishte e ngjashme me periudhën paraprake (0.001 përqind), kurse në depozitat e kursimit shënoi rritje për 0.1 pikë përqindje dhe arriti në 0.4 përqind në TM4 2018.

Performanca e sektorit bankar

Vlera e profitit të realizuar gjatë tremujorit të fundit të vitit 2018 rezultoi të jetë për 10.1 milionë euro më e lartë krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit paraprak, dhe arriti në 26.4 milionë euro (figura 16). Përkundër rritjes së shpenzimeve të sektorit bankar në periudhën raportuese, rritja e theksuar e profitit të

realizuar në TM4 2018 i'u atribuu kryesisht rritjes më të lartë të të hyrave të sektorit.


Figura 16. Profiti neto i sektorit bankar, në milionë euro



Burimi: BQK (2019)

Të hyrat e sektorit bankar në TM4 2018 u karakterizuan me rritje të përshpejtuar, kryesisht si rezultat i performancës në të hyrat nga interesi (kryesisht nga kreditë), por edhe rritjes së të ardhurave nga tarifat dhe komisionet në kuadër të hyrave nga jointerеси (figura 17).

Figura 17. Të hyrat dhe shpenzimet e sektorit bankar



Burimi: BQK (2019)

Në anën tjetër, vlera e gjithsej shpenzimeve të sektorit bankar në TM4 2018 arriti në 46.0 milionë euro, që paraqet një rritje për 2.7 milionë euro krahasuar me tremujorit të njëjtë të vitit paraprak (figura 17). Rritja

**Vlerësimi Tremujor i Sistemit Financiar
Nr. 25, Tremujori IV/2018**


e shpenzimeve të sektorit bankar kryesisht i atribuohet rritjes së shpenzimeve të përgjithshme dhe administrative për 2.2 milionë euro më shumë në TM4 2018 krahasuar me TM4 2017 dhe arritën në 30.7 milionë euro. Në kuadër të këtyre shpenzimeve, ndikimin më të lartë në rritje e kishin nënkategoria e shpenzimeve për personelin, të cilat arritën në vlerë prej 13.3 milionë euro. Kategoria e dytë me rritje rezultoi të jenë shpenzimet për interesa, që në TM4 2018 shënoi rritje vjetore tremujore për 1.9 milionë euro dhe arriti në 6.3 milionë euro. Në kuadër të kësaj nënkategorie të shpenzimeve, rritje të kostos në TM4 2018 shënuan shpenzimet për interesa të depozitave të afatizuara dhe huamarrjeve tjera. Kurse, kategoria e shpenzimeve të jointerestit rezultoi të jetë kategoria e vetme që shënoi rënie dhe u zvogëlua për 2.0 milionë euro kundrejt TM4 2017, në 5.0 milionë euro. Zvogëlimi i shpenzimeve në këtë kategori kryesisht i atribuohet reduktimit të theksuar të shpenzimeve të provizioneve për mbulim të humbjeve të mundshme nga kreditë, që në periudhën raportuese u zvogëluan për 2.9 milionë euro kundrejt TM4 2017, në 0.2 milionë euro.

Si rezultat i nivelit më të lartë të të hyrave të arkëtuara, raporti i shpenzimeve ndaj të hyrave në TM4 2018 u përmirësua edhe më tej, duke rënë për 9.1 pikë përqindje kundrejt periudhës së njëjtë të vitit të kaluar në 63.5 përqind (figura 17).

Rrjedhimisht, pozicioni financiar i sektorit bankar në TM4 2018 u reflektua pozitivisht edhe në dy indikatorët e profitabilitetit, kthimin në mesataren e aseteve (KMA) edhe kthimin në mesataren e kapitalit (KMK). Në TM4 2018, KMA u rrit për 0.9 pikë përqindje në 3.0 përqind, ndërsa KMK u rrit për 8.1

pikë përqindje në 24.9 përqind (figura 18). Rritja e indikatorëve të profitabilitetit pasqyron edhe fitimin rekord të realizuar nga sektori bankar, që gjatë tremujorit të fundit arriti vlerën prej 26.4 milionë euro (16.3 milionë euro në TM4 2017).

Figura 18. Treguesit e profitabilitetit të sektorit bankar




Shënim: Në kalkulim të KMA dhe KMK profiti për tremujorin përkatës është anualizuar
Burimi: BQK (2019)

Treguesit e shëndetit financiar

Sektori bankar po vazhdon të karakterizohet me rënie të nivelit të kredive joperformuese dhe përmirësim të mbulueshmërisë së tyre me provizione. Niveli i kredive joperformuese në fund të TM4 2018 qëndroi në 2.7 përqind, që

Figura 19. Treguesit e kualitetit të portofolios kreditore dhe norma e rritjes së KJP-ve




Shënim: Të dhënat e paraqitura janë me gjendjen në fund të tremujorit të cekur
Burimi: BQK (2019)

paraqet një rënie prej 0.4 pikë përqindje krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak (figura 19).

Niveli i mbulueshmërisë së kredive joperformuese me provizione u përmirësua lehtësisht krahasuar me periudhën paraprake, duke qëndruar në nivel prej 152.0 përqind, një rritje prej 1.5 pikë përqindje.

Niveli i kapitalizimit të sektorit bankar vazhdon të jetë dukshëm mbi nivelin minimal të kërkuar me rregullore prej 12.0 përqind. Treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit në fund të TM4 2018 qëndroi në nivel prej 17.0 përqind.

Figura 20. Treguesit e likuiditetit dhe të solvencës



Treguesi kyç i likuiditetit, raporti i mjeteve likuide ndaj gjithsej detyrimeve afatshkurtra, shënoi rritje në fund të TM4 2018 për 1.2 pikë përqindje kundrejt TM4 2017 si rezultat i rritjes më të lartë të mjeteve likuide kundrejt rritjes së detyrimeve afatshkurtra. Ky indikator qëndroi në nivel prej 39.1 përqind në periudhën raportuese, që është dukshëm mbi nivelin minimal rregullator prej 25 përqind. Raporti kredit/depozitë në fund të TM4 2018 qëndroi në nivel prej 81.9 përqind dhe tejkaloi lehtësisht nivelin e rekomanduar nga BQK prej 80.0 përqind, si rezultat i


rritjes së përsheptuar të kreditimit kundrejt rritjes së depozitave në sektor.

Sektori pensional

Sektori pensional gjatë TM4 2018 u karakterizua me ngadalësim të rritjes, si rezultat i performancës negative të mjeteve të investuara në tregjet e jashtme në muajin e fundit të vitit 2018, përderisa rritja e kontributeve të reja të arkëtuara kontribuoi në rritje të aseteve.

Sektori pensional vazhdon të jetë sektori i dytë për nga pjesëmarrja në asetet e sistemit financiar me 26.8 përqind të gjithsej aseteve. Stoku i aseteve të këtij sektori deri në dhjetor 2018 arriti vlerën prej 1.70 miliardë euro, një rritje vjetore e ngadalësuar prej 2.6 përqind krahas rritjes prej 16.0 përqind në vitin paraprak.

Figura 21. Asetet e sektorit pensional, ndryshimi tremujor




Burimi: BQK (2019)

Gjatë TM4 2018, asetet e menaxhuara nga sektori pensional u zvogëluan për 64.7 milionë euro (figura 21), dinamikë që kryesisht i atribuohet performancës së investimeve të alokuara jashtë vendit, e që përbëjnë pjesën më të madhe të aseteve të fondeve. Në TM4 2018, stoku i investimeve në fondet e përbashkëta të

FKPK-së, që zotëron 99.6 përqind të gjithsej aseteve të sektorit pensional, u zvogëluar për 269.6 milionë euro. Në të njëjtën periudhë, investimet e realizuara në vend, përkatësisht investimet në letrat me vlerë të Qeverisë së Kosovës u shtuan për 16.0 milionë euro. Gjithashtu, gjatë këtij tremujori, një pjesë e aseteve u raportua si para në tranzit, (para në proces për investim jashtë vendit) dhe çertifikata të depozitit, vlera e të cilave rezultoi të jetë për 182.4 milionë euro më e lartë kundrejt tremujorit të kaluar.

Fondet pensionale që operojnë në Kosovë kanë strategji të ndryshme të investimit të aseteve të tyre. Në kuadër të strategjisë për diversifikim të rrezikut nga investimi në fonde të përbashkëta investuese që menaxhohen nga ndërmarrjet për menaxhimin e mjeteve, si pasojë e situatës së paqëndrueshme në tregjet financiare ndërkombëtare, FKPK u fokusua në rritjen e investimeve në letra me vlerë të Qeverisë së Kosovës dhe mbajtjen e aseteve në formë të parave të gatshme dhe instrumenteve të borxhit në TM4 2018.

Figura 22. Struktura e aseteve të FKPK-së (TM4 2018)




Burimi: FKPK (2019)

Në anën tjetër, FSKP investon asetet e tyre kryesisht në aksione jashtë vendit, pasuar nga asetet e

investuara në obligacione si në Kosovë ashtu edhe jashtë vendit (figura 22 dhe 23).


Figura 23. Struktura e aseteve të FSKP-së (TM4 2018)



Burimi: FSKP (2019)

Arkëtime të reja të sektorit gjatë tremujorit të katërt të vitit 2018 u regjistruan në vlerë prej 46.0 milionë euro, që paraqet një rritje prej 8.7 përqind në krahasim me tremujorin e njëjtë të vitit paraprak. Nga këto kontribute të arkëtuara, 99.7 përqind i takojnë FKPK-së.

Figura 24. Kthimi në investime dhe performanca e FKPK-së



Burimi: FKPK (2019)

Në këtë tremujor, FKPK u karakterizua me performancë negative nga investimet, ku vlerësimi i aseteve të investuara u zvogëluar dhe rezultoi në një kthim negativ bruto prej 107.1 milionë euro, krahas kthimit bruto prej 36.1 milionë në tremujorin e katërt

të vitit paraparak (figura 24). Po ashtu, edhe FSKP pati një kthim negativ bruto nga investimet për 446.6 mijë euro, nga 179.2 mijë euro në TM4 2017.

Tregjet financiare në SHBA u karakterizuan me luhatje të mëdha në tremujorin e katërt të vitit 2018, ku indekset kryesore realizuan kthim të lartë pozitiv nga investimet gjatë muajve shtator dhe tetor e rënie të theksuar të vlerës në dhjetor. Rënia e evidentuar kryesisht i'u atribuua shitjes së madhe të instrumenteve financiare nga investitorët dhe tregtuesit e letrave me vlerë, kryesisht si pasojë e mos marrëveshjeve tregtare në mes SHBA-së dhe Kinës; indikacioneve për ngadalësim ekonomik global; rritjes së mëtutjeshme të normës bazë nga Rezerva Federale; pasigurive në lidhje me rritjen potenciale të inflacionit; dhe situatës politike brenda SHBA-ve si dhe jashtë saj (ndikimi i BREXIT-it në Britaninë e Madhe dhe Evropë, si dhe ngadalësimi ekonomik i Kinës).


Dinamikat e tilla në nivel global rezultuan në një kthimin negativ bruto nga investimet të FKPK-së, ku rreth 73 përqind e investimeve të FKPK-së janë të investuara jashtë vendit dhe rrjedhimisht të ekspozuara nga rreziku i lëvizjeve negative në tregjet financiare globale.

Sektori i sigurimeve

Sektori i sigurimeve gjatë këtij tremujori regjistroi përshpejtim të rritjes së bruto primeve të shkruara, gjë që u reflektua në rritjen e të hyrave të sektorit dhe rezultatin pozitiv financiar, përkundër rritjes së dëmeve të ndodhura dhe shpenzimeve.

Asetet e sektorit të sigurimeve gjatë TM4 2018 u karakterizuan me rënie prej 7.5 milionë euro krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit paraparak. Në TM4 2018, asetet e sektorit të sigurimeve u zvogëluan për 3.8 milionë euro, përdërisa stoku i aseteve deri në dhjetor 2018 arriti vlerën prej 177.3 milionë euro në fund të periudhës (rritje vjetore marginale e stokut të aseteve prej 0.2 përqind) (figura 25).

Figura 25. Asetet e sektorit të sigurimeve, ndryshimi tremujor



Burimi: BQK (2019)


Gjatë këtij tremujori, paratë e gatshme dhe depozitat në BQK u karakterizuan me rritje, përdërisa depozitat e mbajtura në bankat komerciale u tkurrën. Në kuadër të investimeve në letrat me vlerë, letrat me vlerë të mbajtura deri në maturim u shtuan gjatë tremujorit ndërsa ato në dispozicion për shitje u zvogëluan.

Ecuria e gjithsej aseteve të sektorit reflekton zhvillimet në sektorin e sigurimeve 'jo-jetë', asetet e të cilave u zvogëluan për 3.0 milionë euro në krahasim me tremujorin e katërt të vitit paraparak. Edhe pse sektori 'jetë' ka peshë të vogël në gjithsej asetet e sektorit të sigurimeve, rënia e aseteve të tyre për 4.5 milionë euro ndikoi po ashtu në tkurrjen e aseteve të sektorit. Në

rënien e aseteve të sektorit jetë ka ndikuar tërheqja nga tregu i njëjës prej kompanive të sigurimit të jetës.

Vlera e primeve të shkruara nga kompanitë e sigurimeve gjatë TM4 2018 arriti vlerën prej 23.0 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 10.6 përqind. Primet e sigurimit jo-jetë përfaqësojnë 96.6 përqind të gjithë strukturës së primeve të shkruara. Vlera e primeve të shkruara nga sigurimi 'jo-jetë' u rrit për 10.3 përqind dhe arriti në 22.2 milionë euro. Ndërsa, vlera e primeve të shkruara nga sigurimi 'jetë' u karakterizua me rritje vjetore prej 21.9 përqind duke arritur në 781.8 mijë euro.

Figura 26. Primet e shkruara dhe dëmet e paguara



Dëmet e paguara nga sektori i sigurimeve dhe Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS) u zvogëluan në 12.9 milionë euro në TM4 2018 (13.6 milionë euro në TM4 2017), që paraqet një rënie vjetore prej 4.7 përqind. Rënia e nivelit të dëmeve të paguara dhe rritja e arkëtimit prej primeve të shkruara, ndikoi në përmirësimin e raportit dëme/prime, i cili në TM4 2018 zbriti në 56.2 përqind nga 65.3 përqind sa ishte në tremujorin e katërt të vitit 2017. Ky zhvillim nënkupton që një shumë më e vogël e të ardhurave nga primet dedikohet për mbulimin e dëmeve (figura 26).

Performanca e sektorit të sigurimeve

Sektori i sigurimeve në TM4 2018 shënoi rezultat pozitiv financiar, edhe pse me fitim neto më të ulët për dallim nga TM4 2017 si pasojë e rritjes më të lartë të dëmeve të ndodhura dhe rritjes vjetore të shpenzimeve krahas rritjes së të hyrave.

Të hyrat neto nga primet e sektorit të sigurimeve në TM4 2018 shënuan rritje vjetore prej 6.2 përqind, përderisa në të njëjtën periudhë, shpenzimet e sektorit të sigurimeve si dhe dëmet e ndodhura u karakterizuan me rritje prej 4.7 përqind, respektivisht 37.8 përqind krahasuar me TM4 2017. Rrjedhimisht, pavarësisht rritjes së dëmeve të ndodhura dhe shpenzimeve, rritja e të hyrave të sektorit mundësoi një performancë pozitive edhe pse më të ulët krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit paraprak, saktësisht fitim prej 0.9 milionë euro nga 3.3 milionë euro në TM4 2017.

Sa i përket pozitës së likuiditetit të sektorit, ky indikator tregoi rënie të likuiditetit, duke marr për bazë stokun e aseteve deri në dhjetor 2018. Rënia e indikatorit të likuiditetit të sektorit i atribuohet kryesisht rënies vjetore së stokut të parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj (3.0 përqind) kundrejt rritjes së rezervave teknike (2.4 përqind), ku raporti në mes tyre zbriti në 98.7 përqind nga 104.3 përqind në dhjetor 2017. Gjithashtu, treguesi tjetër i likuiditetit u zvogëlua, kryesisht i ndikuar nga rënia marginale e gjithësej detyrimeve prej 0.2 përqind kundrejt rënies më të lartë të stokut të parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj. Raporti ndërmjet parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj ndaj gjithësej

detyrimeve në dhjetor 2018 qëndroi në 88.7 përqind, nga 91.3 përqind sa ishte në dhjetor të vitit të kaluar.


Sektori mikrofinanciar

Rritja e theksuar e asetëve të sektorit vazhdon të jetë e mbështetur kryesisht nga rritja e theksuar e kreditimit nga ky sektor. Rrjedhimisht, sektori u karakterizua me rritje të të hyrave dhe performancë pozitive financiare.

Asetet

Sektori mikrofinanciar ishte sektori me rritjen më të lartë të stokut të asetëve në kuadër të sistemit financiar deri në dhjetor të vitit 2018. Edhe pse pesha e këtij sektori në gjithsej asetet e sistemit financiar është rritur, vazhdon të mbetet e ulët në rreth 4.0 përqind.

Figura 27. Asetet e sektorit mikrofinanciar, ndryshimi tremujor



Burimi: BQK (2019)

Gjatë tremujorit të katërt të vitit 2018, vlera e asetëve të sektorit mikrofinanciar ishte 13.7 milionë euro (8.6 milionë euro në TM4 2017) (figura 27), dhe arriti në 249.9 milionë euro në dhjetor 2018.


Zgjerimi i sektorit mikrofinanciar kryesisht i atribuohet rritjes së aktivitetit kreditues, aktivitetet që

financohet kryesisht nga huazimet në sektorin e jashtëm (67.3 përqind të gjithsej asetëve).

Kreditë

Gjatë TM4 2018, stoku i kredive u shtua për 10.0 milionë euro, një rritje për 1.2 milionë euro kundrejt vlerës në TM4 2017 (figura 28). Kreditë për ekonomitë familjare, që kanë një pjesëmarrje prej 65.8 përqind në gjithsej kreditë e sektorit, përsheptuan rritjen për 7.0 milionë euro (4.2 milionë euro në TM4 2017). Në anën tjetër, kreditë ndaj ndërmarrjeve, që përfaqësojnë 34.2 përqind të gjithsej kredive të sektorit, u shtuan për 3.1 milionë euro e që është vlerë më e vogël me atë të TM4 2017 (figura 28). Si rezultat i këtyre dinamikave, stoku i kredive të lëshuara për ndërmarrjet dhe ekonomitë familjare shënoi rritje të theksuar vjetore.

Figura 28. Vlera e kredive ndaj ekonomive familjare dhe ndërmarrjeve, ndryshimi vjetor i kredive




Burimi: BQK (2019)

Sa i përket kreditimit ndaj sektorëve ekonomik, stoku i kredive ndaj sektorëve më të rëndësishëm kreditues siç janë ai i industrisë, bujqësisë, ndërtimitarisë, dhe tregtisë u karakterizuan me ecuri pozitive. Gjatë TM4 2018, rritja vjetore e aktivitetit kreditues sipas

sektorëve ekonomik rezultoi më e ngadalshme kundrejt vitit paraprak. Sektori që shënoi rritjen më të lartë në këtë tremujor ishte ai i 'shërbimeve tjera' me rritje prej 1.0 milionë euro, që përfaqëson kategorinë dominuese të kredive për ndërmarrje (33.5 përqind të gjithsej stokut të kredive për ndërmarrje) (figura 29).

Figura 29. Vlera e kredive ndaj ndërmarrjeve, sipas sektorëve ekonomik në TM4




Burimi: BQK (2019)

Lizingjet

Stoku i lizingjeve gjatë tremujorit të katërt të vitit 2018 u shtua për 2.9 milionë euro (0.5 milionë euro në TM4 2017) (figura 30).

Figura 30. Vlera e lizingjeve të sektorit mikrofinanciar




Burimi: BQK (2019)

Në rritjen e vlerës së lizingjeve gjatë këtij tremujori kontribuoi rritja e "lizingjeve tjera" dhe lizingjet për pajisje kryesisht për ndërmarrje dhe rritja e lizingut hipotekar për ekonomitë familjare.

Normat e Interesit

Normat mesatare të interesit në kredi në tremujorin e katërt të vitit 2018 ndërruan kahjen e trendit rritës të vitit të fundit, duke zbritur në 22.2 përqind, nga 22.5 përqind sa ishte mesatarja për TM4 2017. Të njëjtin trend ndoqën si normat e interesit për ndërmarrjet ashtu edhe ato të ekonomive familjare, më saktësisht rënie për 1.5 pikë përqindje, respektivisht 0.3 pikë përqindje (figura 31).

Figura 31. Norma mesatare e interesit në kredi të sektorit mikrofinanciar




Burimi: BQK (2019)

Në kuadër të ekonomive familjare, norma mesatare e interesit në kreditë konsumuese shënoi rritje për 1.6 pikë përqindje në 26.1 përqind, përderisa norma mesatare e interesit në kreditë hipotekare u zvogëlua për 4.3 pikë përqindje në 20.9 përqind.

Në kuadër të kredive ndaj ndërmarrjeve, sektori i shërbimeve vijon të ketë normën më të ulët të interesit në kredi, duke zbritur edhe më tutje gjatë TM4 2018 për 4.6 pikë përqindje në 15.2 përqind. Ndërsa, sektori i industrisë mbetet sektori me normën më të lartë të

interesit në kredi prej 22.8 përqind, përkundër rënies prej 1.7 pikë përqindje të normës së interesit krahas TM4 2017 (figura 32).

Figura 32. Norma mesatare e interesit në kredi për ndërmarrje, sipas sektorëve ekonomik




Burimi: BQK (2019)

Performanca e sektorit mikrofinanciar

Zhvillimet në aktivitetin kreditues dhe aktivitetin e lizingut në kuadër të sektorit rezultuan në performancë të mirë financiare për institucionet mikrofinanciare edhe gjatë TM4 2018. Profiti i sektorit u shtua në vlerë prej 1.9 milionë euro kundrejt TM4 2017, kur ky sektor realizoi profit prej 1.4 milionë euro (figura 33).

Rritja e profitit kryesisht i atribuohet rritjes së theksuar të hyrave prej 3.1 milionë euro, vlera e të cilave arriti në 11.9 milionë euro në TM4 2018. Më konkretisht, rritja e profitit i atribuohet rritjes të hyrave nga interesi për 9.9 milionë euro, kategori që përfaqëson 86.6 përqind të gjithë të hyrave.


Figura 33. Të hyrat dhe shpenzimet e sektorit mikrofinanciar



Burimi: BQK (2019)

Rritja e të hyrave nga interesi ishte rezultat i rritjes së theksuar të aktivitetit kreditues nga institucionet mikrofinanciare në vazhdimësi gjatë tre viteve të fundit. Gjithsej shpenzimet e sektorit po ashtu shënuan rritje prej 2.6 milionë euro krahas TM4 2017 dhe arritën në 10.0 milionë euro në TM4 2018. Rritjen më të madhe e patën shpenzimet nga jo-interesi, të cilat u shtuna për 5.8 milionë euro. Në ecurinë e

Figura 34. Treguesit e profitabilitetit të sektorit mikrofinanciar



*Profiti është analizuar për tremujorin përkatës

Burimi: BQK (2019)


shpenzimeve të sektorit kontribuoi rritja e shpenzimeve për personelin dhe atyre administrative si pasojë e rritjes së numrit të të punësuarve në këtë sektor. Po ashtu, ndikim kishte edhe rritja e shpenzimeve për provizionet për humbjet e mundshme

nga mos kthimi i kredive, edhe pse në masë më të vogël.

Si rezultat i performancës pozitive financiare gjatë tremujorit, e po ashtu gjatë vitit 2018 në përgjithësi treguesit e profitabilitetit, të analizuar për tremujorin përkatës, shënuan përmirësim (figura 34).

Institucionet mikrofinanciare vazhdojnë të karakterizohen me nivel të ulët të kredive me probleme dhe mbulueshmëri të mirë me provizione.

Figura 35. Treguesit e kualitetit të portofolios kreditorë




— KJP-të — Mbulueshmëria e KJP-ve me provizione (boshti i djathtë)
Burimi: BQK (2019)

Niveli i kredive joperformuese në raport me gjithsej kreditë deri në dhjetor 2018 shënoi rënie për 0.1 pikë përqindje krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, në 2.4 përqind (figura 35). Kurse, niveli i mbulueshmërisë së kredive joperformuese me provizione në dhjetor 2018 arriti në 208.8 përqind krahasuar me nivelin prej 190.3 përqind në dhjetor 2017.

Tregu i letrave me vlerë

Gjatë tremujorit të katërt, Departamenti i Thesarit i Ministrisë së Financave të Qeverisë së Kosovës realizoi 5 ankande, në të cilat u emetuan bono dhe fletë-obligacione qeveritare në vlerë prej 95.0 milionë euro.

Figura 36. Shuma e borxhit të emetuar, rritja vjetore



Burimi: Ministria e Financave

Vlera e emetuar e letrave me vlerë në këtë tremujor ishte 18.8 përqind më e lartë se në tremujorin e njëjtë të vitit të kaluar, kurse për 11.2 përqind më e ulët se në tremujorin paraprak (figura 36). Rritjen e theksuar në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, e ndikoi rritja e vlerës së emetuar të fletë-obligacioneve qeveritare (tabela 1).

Tabela 1. Numri dhe shuma e letrave me vlerë të arkëtuara nga Qeveria e Kosovës

Periudha	Bono dhe thesarit		Fletë-obligacionet	
	Numri i realizuar	Vlera e pranuar	Numri i realizuar	Vlera e pranuar
TM4 2015	3	65.00	2	35.00
TM4 2016	3	65.00	1	20.00
TM4 2017	2	49.95	2	30.00
TM4 2018	2	40.00	3	55.00

Burimi: Ministria e Financave (2019)


Norma mesatare e interesit në letrat me vlerë në TM4 2018 ka shënuar rritje (2.1 përqind) krahasuar me TM4 2017 (1.2 përqind). Kjo rritje mund të jetë ndikuar

**Vlerësimi Tremujor i Sistemit Financiar
Nr. 25, Tremujori IV/2018**

nga emetimi i fletë-obligacioneve me maturitet më të gjatë krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit paraprak. Po ashtu, rritja e normës mesatare të interesit mund të jetë ndikuar edhe nga interesimi i pjesëmarrësve në ankande të letrave me vlerë. Shuma e ofertuar nga pjesëmarrësit në ankand ishte për 1.7 herë më e lartë se shumta e emetuar në ankande nga Ministria e Financave (2.1 herë më i lartë në TM4 2017) (figura 37).

Ngjashëm me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, nuk janë emetuar bono me afat maturimi 91 ditë, njëkohësisht trendi i emetimit të letrave me vlerë është i orientuar nga emetimi i fletë-obligacioneve qeveritare me afat më të gjatë të maturimit si rezultat i kthimit më të madh në investim (figura 38).


Figura 37. Shuma e ofruar dhe emetuar



Burimi: Ministria e Financave (2019)

Struktura e letrave me vlerë sipas afatit të maturimit në këtë tremujor dominohet nga fletë-obligacionet qeveritare me afat maturimi 5 vite me pjesëmarrje prej 26.3 përqind, në të njëjtën kohë pjesëmarrje të njëjtë kishin edhe bonot e thesarit me afat maturimi 182 ditë.

Figura 38. Struktura e letrave me vlerë të Qeverisë, në përqindje



Burimi: Ministria e Financave (2019)

Citimi i sugjeruar i këtij publikimi:

BQK (2019): Vlerësimi Tremujor i Sistemit Financiar Nr. 25, TM4 2018, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Prishtinë

Referencat:

BQK (2018):

- a) Buletini Mujor Statistikor: <http://bqk-kos.org/?id=97>
- b) Statistikat zyrtare të BQK-së, Seritë kohore: <http://www.bqk-kos.org/?cid=1,124>

ASK (2018):

- a) Indeksi i çmimeve të konsumit: http://esk.rks-gov.net/publikimet/cat_view/98-cmimet/15-indeksi-i-cmimeve-te-konsumit-
- b) Indeksi i çmimeve të prodhimit: http://esk.rks-gov.net/publikimet/cat_view/98-cmimet/79-indeksi-i-cmimeve-te-prodhimit-
- c) Indeksi i çmimeve të importit: http://esk.rks-gov.net/publikimet/cat_view/98-cmimet/80-indeksi-i-cmimeve-te-importit-
- d) Reportori Statistikor mbi ndërmarrjet ekonomike: <http://esk.rks-gov.net/regjistri-statistikor-i-bizneseve/publikimet>
- e) Statistikat e tregtisë së jashtme: <http://esk.rks-gov.net/tregtia-e-jashtme/publikimet>
- f) Buletini Tremujor

Të tjera (2018):

- a) Shpalljet dhe Rezultatet e ankandëve për letra me vlerë të qeverisë: <https://mf.rks-gov.net/page.aspx?id=1,46>
- b) Fondi Kosovar për Garanci Kreditore: <http://www.fondikgk.org/>
- c) Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës; Raporte tremujore: <http://www.trusti.org/sq/per-ne/raporte/835-2/>

Bloomberg (2018): Metal Prices database.

FAOUN (2018): World Food Prices, Food and Agriculture Organization of United Nations: <http://www.fao.org/worldfoodsituation/foodpricesindex/en/>

Euribor (2018): Euribor Historical Rates:

<http://www.euribor-ebf.eu/euribor-org/euribor-rates.html>

IMF (2018): World Economic Outlook:

<http://www.imf.org/external/pubs/ft/weo/2016/02/weodata/index.aspx>

Treguesit e zgjedhur makroekonomik

Përshkrimi	2017	2018
Sektori real 1/		
Bruto Produkti Vendor (BPV) (në milionë euro)	6,413.8	6,739.0
Çmimet e konsumit (mesatarja vjetore)	1.5%	1.1%
Çmimet e konsumit (fondi i periudhës)	0.5%	2.9%
Sektori fiskal* 2/		
Të hyrat buxhetore (në milionë euro)	1,530.4	1,598.1
Shpenzimet buxhetore (në milionë euro)	1,464.5	1,655.3
Bilanci primar (në milionë euro)	65.9	-57.2
Sektori financiar (në milionë euro) 3/		
Asetet e korporatave financiare	5,907.9	6,322.9
prej të cilave: Bankat	3,869.8	4,183.9
Kredi	2,485.5	2,755.5
Depozita	3,094.5	3,364.6
Norma e interesit në kredi, fondi i periudhës	6.8%	6.0%
Norma e interesit në depozita, fondi i periudhës	1.3%	1.5%
Hendeku i normës së interesit	5.5%	4.5%
Sektori i jashtëm, (në milionë euro) 3/		
Bilanci i pagesave		
Llogaria rrjedhëse dhe kapitale	-395.0	-575.0
prej të cilave: remitencat e pranuar	689.8	731.4
Llogaria financiare	-284.3	-287.2
Investimet e huaj direkte në Kosovë	255.4	231.7
Investimet portfolio, net	14.7	-79.9
Investimet tjera, net	-156.9	-104.5
Pozicioni ndërkombëtar i investimeve (PNI), net*	-78.6	-113.7
Asetet	4,774.8	5,001.4
Detyrimet	4,853.4	5,115.1
Borxhi i jashtëm, gjithsej*	2,069.2	2,089.5
Borxhi i jashtëm privat	1,570.7	1,594.7
Borxhi i jashtëm publik	498.5	494.8

Burimi:

1/ ASK (2019), BPV për vitin 2018 është vlerësim i BQK-së;

2/ MF (2019);

3/ BQK (2019).

*Të dhënat për sektorin fiskal janë deri në nëntor ndërsa për PNI dhe borxh të jashtëm deri në shtator.

